



Në bazë të nenit 35 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 dhe nenit 65 paragrafi 1 të Ligjit nr.03/L-209 mbi Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 77/16 Gusht 2010), nenit 8 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 të Ligjit nr. 04/L-155 për Sistemin e Pagesave (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 12/03 maj 2013), nenit 92 paragrafi 3, nenin 94 paragrafi 4 si dhe nenit 114 të Ligjit Nr.04/L-093 mbi Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.11/11 maj 2012), Bordi i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës në mbledhjen e mbajtur më 29 nëntor 2019 miratoi këtë:

RREGULLORE PËR EMETIMIN E PARASË ELEKTRONIKE

Neni 1

Qëllimi dhe fushëveprimi

1. Qëllimi i kësaj rregullore është përcaktimi i kushteve, kërkesave dhe procedurave për veprimtarinë e emetimit të parasë elektronike, si dhe përcaktimi i mënyrës së raportimit të informacionit për përdorimin e saj.
2. Subjekt i zbatimit të kësaj rregullore janë bankat dhe institucionet financiare jobankare të licencuara/regjistruara nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës që të ushtrojnë veprimtarinë e emetimit të parave elektronike.

Neni 2

Përkufizimet

1. Të gjitha termet në këtë rregullore kanë të njëjtin kuptim me termet e përkufizuara në Ligjin për Sistemin e Pagesave dhe/ose me përkufizimet si më poshtë për qëllimin e kësaj rregullore:
 - 1.1. **Para elektronike** – vlera monetare e ruajtur në formë elektronike, duke përfshirë edhe formën magnetike, siç paraqitet nga kërkesa ndaj emetuesit, që emetohet pas pranimit të fondeve me qëllim të kryerjes së transaksioneve të pagesave dhe e cila pranohet si mjet i pagesës nga personat tjerë përveç emetuesit të parasë elektronike;
 - 1.2. **Instrument i parasë elektronike** – është një instrument pagese, i ndryshëm nga instrumenti i pagesave me qasje në distancë, i cili ruan vlera monetare në formë elektronike dhe i mundëson mbajtësit të kryejë pagesa elektronike. Ky instrument mund të rimbushet me vlera monetare sa herë që është e nevojshme;
 - 1.3. **Emetues** – është banka dhe/ose IFJB e licencuar/regjistruar nga BQK-ja për ushtrimin e veprimtarisë së emetimit të parasë elektronike, që në bazë të kontratës i emeton mbajtësit për përdorim, instrumentin e parasë elektronike;
 - 1.4. **Pranues** – është banka dhe/ose IFJB e licencuar/regjistruar nga BQK-ja, që në bazë të kontratës me tregtarin pranon pagesat elektronike të iniciuara nga mbajtësi nëpërmjet instrumentit të parave

elektronike dhe të realizuara tek tregtari, nëpërmjet POS/EFTPOS ose virtual POS. Pranuesi mund të jetë njëkohësisht edhe emetues dhe anasjelltas;

- 1.5. **Mbajtës** – është personi fizik ose juridik, i cili në bazë të kontratës përkatëse me emetuesin mban instrumentin e parasë elektronike;
- 1.6. **Tregtar** - është personi fizik ose juridik, i cili në bazë të kontratës së lidhur me pranuesin, pranon pagesat me instrument të parasë elektronike nëpërmjet përdorimit të një pajisje POS/EFTPOS/virtual POS;
- 1.7. **Terminal POS/EFTPOS** – është pajisja që bën të mundur përdorimin e instrumenteve të parasë elektronike në një pikë të shitjes;
- 1.8. **Terminal virtual POS (virtual POS)** - është pajisja apo aplikacion i ngjashëm në shërbime me terminalin POS, që mundëson kryerjen e transaksioneve nëpërmjet internetit ose telefonave, me anë të kartelave të parasë elektronike që punojnë në kohë reale;
- 1.9. **Zyra e bankës dhe/ose e IFJB-së** – vend i veprimtarisë afariste i cili formon një njësi/zyrë ligjërish të varur të bankës dhe/ose e IFJB-së e pa themeluar me vete, nëpërmjet të cilës banka dhe/ose IFJB mund të lejohet që të angazhohet në veprimtari emetimit të parasë elektronike;
- 1.10. **BQK** – Banka Qendrore e Republikës së Kosovës;
- 1.11. **IFJB** – Institucion Financiar Jobankare.

Neni 3

Emetuesit e parasë elektronike

1. Paraja elektronike në Republikën e Kosovës mund të emetohet nga:
 - 1.1. Bankat e licencuara nga BQK-ja;
 - 1.2. IFJB-të e regjistruara nga BQK-ja për ushtrimin e veprimtarisë së emetimit të parasë elektronike;
 - 1.3. BQK kur nuk vepron në cilësinë e autoritet rregullativ;
 - 1.4. Institucionet qeveritare (qendrore dhe lokale) kur nuk veprojnë si autoritete publik.
2. Asnjë person tjetër, përveç atyre të cekur në paragrafin 1 të këtij neni, nuk mund të emetojnë para elektronike në Republikën e Kosovës.

Neni 4

Veprimtaria e emetimit të parasë elektronike

1. Veprimtarinë e emetimit të parasë elektronike mund ta kryejnë vetëm institucionet e përcaktuara në nenin 3 paragrafi 1 të kësaj rregullore.
2. Çdo fond i pranuar nga ana e IFJB prej mbajtësit të parasë elektronike duhet të këmbëhet në para elektronike menjëherë. Këto fonde nuk përbëjnë depozitë dhe as fonde tjera të ripagueshme të pranuar nga publiku.

Neni 5
Kërkesat për mbrojtjen e fondeve

1. IFJB-të e regjistruara për emetimin e parasë elektronike duhet t'i mbrojnë fondet që janë marrë në këmbim të parave elektronike të emetuara, siç është përcaktuar në Rregulloren për kapital rregullator dhe ruajtje të fondeve të Institucioneve Financiare Jobankare.

Neni 6
Emetimi i parasë elektronike

1. Emetuesi i parasë elektronike emeton para elektronike për një vlerë të barabartë me vlerën nominale të fondeve të marra nga mbajtësi i parasë elektronike.
2. Mbajtësi i parasë elektronike është pronari i fondeve që pranoen nga emetuesi i parasë elektronike.

Neni 7
Kthimi i fondeve (Redeem)

1. Emetuesi, me kërkesë të mbajtësit, i kthen atij (mbajtësit) në çdo moment, në vlerë nominale, vlerën monetare të parasë elektronike të mbajtur.
2. Kthimi i fondeve mund të jetë objekt i aplikimit të tarifave, nëse këto tarifa përcaktohen në kontratën mes emtuesit dhe mbajtësit të parasë elektronike në rastet e mëposhtme:
 - 2.1. kur kthimi kërkohet nga ana e mbajtësit të parasë elektronike përpara përfundimit të kontratës;
 - 2.2. kur kontrata përcakton një datë për përfundimin e saj dhe mbajtësi i parasë elektronike e përfundon kontratën, para datës së përfundimit; ose
 - 2.3. kur kthimi i fondeve të papërdorura, kërkohet pas më shumë se një viti, nga data e përfundimit të kontratës.
3. Mbajtësi i parasë elektronike mund të kërkojë kthimin e plotë apo të pjesshëm të fondeve para përfundimit të kontratës së lidhur me emetuesin e parasë elektronike.
4. Kur kërkesa për kthimin e fondeve bëhet deri në një vit pas datës së përfundimit të kontratës, emetuesi i parasë elektronike duhet ti kthej gjithsej vlerën monetare të mbajtura si para elektronike.
5. Çdo tarifë sipas paragrafit 2 të këtij neni duhet të jetë e përshtatshme dhe në përputhje me shpenzimet aktuale të krijuara nga emetuesit të parasë elektronike.

Neni 8
Emetimi dhe shpërndarja e parasë elektronike përmes zyrave dhe agjentëve

1. Bankat dhe/ose IFJB-të e licencuara/regjistruara për ushtrimin e veprimtarisë së emetimit të parasë elektronike mund të emetojnë para elektronike përmes zyrave të tyre.
2. Bankat dhe/ose IFJB-të e licencuara/regjistruara për emetimin e parasë elektronike nuk mund të emetojnë para elektronike nëpërmjet agjentëve, por mund të shpërndajnë dhe/ose të kthejnë fondet (redeem) nëpërmjet një ose më shumë agjentëve, të cilët veprojnë për llogari të saj.

Neni 9

Ndalimi i pagesës së interesit

1. Emetuesi nuk do të paguaj interes ose çdo lloj përfitimi tjetër mbajtësit të parasë elektronike, për mbajtjen e parasë elektronike, gjatë kohës që mbanë paranë elektronike.

Neni 10

Kontrata mes emetuesit dhe mbajtësit të parasë elektronike

1. Marrëdhëniet e ndërsjella mes emetuesit dhe mbajtësit të parasë elektronike rregullohen në mënyrë kontraktuale në formë të shkruar.
2. Kontrata sipas paragrafit 1 të këtij neni duhet të përmbajë së paku kushtet si më poshtë:
 - 2.1. Kontrata për mbajtjen dhe përdorimin e parasë elektronike hartohet në gjuhën zyrtare në përputhje me ligjet e aplikueshme në Kosovë;
 - 2.2. Kontrata midis emetuesit dhe mbajtësit të parasë elektronike përcakton qartë dhe në formë të kuptueshme kushtet në lidhje me emetimin e parasë elektronike, kthimin e fondeve (redeem) dhe tarifatat nëse aplikohen;
 - 2.3. Para nënshkrimit të kontratës, emetuesi i shpalosë informatat mbajtësit potencial të parasë elektronike për të gjitha kushtet e kontratës duke i sqaruar me kujdes të drejtat dhe detyrimet reciproke;
 - 2.4. Kontrata për mbajtjen dhe përdorimin e parasë elektronike, duhet të përmbajë të paktën informacionet e mëposhtme:
 - 2.4.1. palët në kontratë;
 - 2.4.2. llojin e instrumentit të pagesave në të cilin ruhet paraja elektronike, si dhe llojin e pajisjes/mjetit në të cilin mbajtësi mund ta përdor për të kryer transaksione;
 - 2.4.3. llojet e transaksioneve të pagesave që mund të kryhen;
 - 2.4.4. kohëzgjatjen/limitin e periudhës së përdorimit ose afatin e vlefshmërisë së parasë elektronike;
 - 2.4.5. procedurat e aplikueshme të sigurisë dhe detyrimet e palëve në kontratë;
 - 2.4.6. llojin dhe vlerën e tarifave dhe provizioneve që lidhen me përdorimin e parasë elektronike si dhe kushtet për ndryshimin e tyre;
 - 2.4.7. rregullat për kryerjen e transaksioneve me valutë të huaj si dhe kushtet për ndryshimin e tyre;
 - 2.4.8. të drejtën dhe procedurat e parashtrimit të ankesës, si dhe procesin e trajtimit të saj;
 - 2.4.9. kushtet dhe afatet në lidhje me përtëritjen e kontratës;
 - 2.4.10. mënyrën, afatin e lajmërimit, kushtet për zgjidhjen e kontratës; dhe
 - 2.4.11. procedurat dhe pasojat në rastet e humbjes, shkatërrimit, keqpërdorimit, vjedhjes, falsifikimit apo kopjimit të instrumentit në të cilin ruhet paraja elektronike.
 - 2.5. Kontratës i bashkëngjiten dokumentet e mëposhtme:
 - 2.5.1. lista me vlerën e limiteve të lejuar për të kryer transaksione, tarifave dhe provizioneve, si dhe referencë për datën e kuotimit të normave të kursit të këmbimit të aplikueshme për përdorim të parasë elektronike brenda dhe jashtë vendit;
 - 2.5.2. përshkrimin mbi mënyrën e përdorimit të instrumentit në të cilin mbahet paraja elektronike dhe të pajisjeve ku ajo përdoret.

2.5.3. standardet dhe procedurat e sigurisë.

3. Emetuesi duhet të njoftojë me shkrim mbajtësin për propozimet e ndryshimeve të dispozitave të kontratës, së paku (1) muaj para se ndryshimi të jetë efektivë.
4. Gjatë periudhës një mujore për shkaqet sipas paragrafit 3 të këtij neni, mbajtësi mund të zgjidh kontratën me emetuesin e parasë elektronike pa ndonjë gjobë apo kosto.

Neni 11

Llojet e instrumenteve të parasë elektronike

1. Instrumentet dhe produktet e parasë elektronike mund të jenë të bazuara në harduer ose softuer, varësisht nga teknologjia e përdorur për të ruajtur vlerën monetare, në format e mëposhtme:
 - 1.1. pajisjet fizike personale, të tilla si karta me chip, me karakteristika të sigurisë të bazuara në harduer;
 - 1.2. produkte të bazuara në softuer që përdorin softuer të specializuar që funksionojnë në pajisjet e zakonshme personale siç janë kompjuterët personal, tabletët ose telefonat mobil;
 - 1.3. skemat të kombinuara me veçoritë e harduerit dhe ato të bazuara në softuer.
2. Bankat dhe/ose IFJB-të të licencuara/regjistruara për ushtrimin e veprimtarisë së emetimit të parasë elektronike që lëshojnë një lloj të ri të instrumenteve të parasë elektronike, së paku një (1) muaj përpara duhet të njoftojnë me shkrim Departamentin e Licencimit dhe Standardizimit në BQK lidhur me instrumentin e ri të parasë elektronike, mënyrën e ofrimit dhe mundësitë e përdorimit të tij, si dhe vlerësimin e tregut për këtë shërbim. BQK mundet në çdo kohë të ndalojë lëshimin apo përdorimin e llojit të ri të instrumenteve të parasë elektronike nëse sipas vlerësimit të saj nuk janë përmbushur kërkesat e kësaj rregullore.

Neni 12

Përjashtimet

1. Për qëllime të kësaj rregullore, nuk do të konsiderohen si para elektronike:
 - 1.1. vlerat monetare që ruhen në instrumente të parapaguara, që përdoren me qëllimin për të përmbushur nevoja specifike të klientëve dhe që mund të përdoren në mënyrë të kufizuar sepse:
 - 1.1.1. i japin mundësinë mbajtësit të blejë mallra dhe/ose shërbime të caktuara, të ofruara nga emetuesi vetëm në ambientet ku zhvillon veprimtarinë emetuesi i parasë elektronike ose brenda një rrjeti të përcaktuar ofruesish shërbimesh, subjekte të një marrëveshjeje tregtare me emetuesin e parasë elektronike (një dyqan i caktuar, zinxhir dyqanesh etj.); ose
 - 1.1.2. mund të përdoren për të blerë vetëm një numër të kufizuar mallrash dhe/ose shërbimesh;
 - 1.1.3. instrumente të vlefshme vetëm në Kosovë të siguruara me kërkesë të një ndërmarrje ose një entiteti të sektorit publik dhe të rregulluara nga një autoritet publik për qëllime specifike sociale ose tatimore për të marrë mallra ose shërbime specifike nga furnitorët që kanë një marrëveshje tregtare me emetuesin.
 - 1.2. vlera monetare që ruhet në instrumentet e pagesave që ofrohen nga një ofrues i rrjeteve ose shërbimeve të komunikimeve elektronike për një abonent të rrjeteve ose shërbimeve:
 - 1.2.1. për blerjen e përmbajtjes dixhitale dhe shërbimeve me bazë zëri, pavarësisht pajisjes së përdorur; ose

- 1.2.2. të kryera nga ose përmes një pajisje elektronike në kuadër të një aktiviteti bamirës apo për blerjen e biletave;
2. Nënparagrafi 1.2 i paragrafit 1 të këtij neni aplikohet në rastet kur vlera e çdo transaksioni të vetëm nuk kalon vlerën 50 EUR dhe/ose vlera kumulative e transaksioneve të pagesave për një abonent individual nuk kalon vlerën 300 EUR në muaj.

Neni 13

Pranimi i parave elektronike nga tregtarët

1. Marrëdhëniet për pranimin e pagesave me para elektronike krijohen dhe përcaktohen nëpërmjet kontratës me shkrim midis pranuesit dhe tregtarit.
2. Pranuesit e parasë elektronike, janë të detyruar të zbatojnë kërkesat për transparencën ndaj tregtarit, si më poshtë:
 - 2.1. Kontrata për pranimin e pagesave me para elektronike hartohet në gjuhën zyrtare në përputhje me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës;
 - 2.2. Para nënshkrimit të kontratës, pranuesi i paraqet tregtarit të gjitha kushtet e kontratës duke sqaruar të drejtat dhe detyrimet reciproke. Kontrata duhet të përmbajë të paktën informacionet e mëposhtme:
 - 2.2.1. palët në kontratë;
 - 2.2.2. llojin e instrumentit të pagesave në të cilin ruhet paraja elektronike që do të përdoret për kryerjen e transaksioneve tek tregtari;
 - 2.2.3. procedurat e aplikueshme, përfshirë procedurat e sigurisë dhe detyrimet e tregtarit gjatë kryerjes së transaksioneve;
 - 2.2.4. periudhën dhe mënyrën e kryerjes së pagesës nga pranuesi për tregtarin;
 - 2.2.5. rastet e refuzimit të pranimin të kryerjes së pagesës me para elektronike;
 - 2.2.6. rastet e mbajtjes/bllokimit të instrumentit të pagesave në të cilin është vendosur paraja elektronike;
 - 2.2.7. procedurat në lidhje me të drejtën e ushtrimit të ankesave;
 - 2.2.8. kushtet dhe afatet në lidhje me përtëritjen e kontratës;
 - 2.2.9. mënyrën, afatin e lajmërimit dhe kushtet për zgjidhjen (përfundimin) e kontratës;
 - 2.2.10. masat për mbrojtje e mbajtësit të parasë elektronike të përcaktuara në nenin 14 të kësaj rregullore;
 - 2.2.11. tarifatat e aplikuara.
3. Kontrata nuk duhet të përmbajë asnjë dispozitë ndaluese për tregtarin, që të përdorë vetëm sistemin e një pranuesi, emetuesi apo grup të pranueseve dhe/ose emetueseve.
4. Pranuesi, për pranimin e pagesave me para elektronike, duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme:
 - 4.1. të bëjë të mundur pranimin dhe kryerjen e transaksioneve me para elektronike;
 - 4.2. të regjistrojë çdo transaksion dhe të ruajë regjistrimet për së paku 5 vite, në mënyrë që të mundësohet identifikimi i transaksioneve të realizuara dhe rregullimi i gabimeve në rastet e përcaktuara në kontratë;
 - 4.3. të zbatojë procedurat e sigurisë për garantimin e kryerjes së transaksioneve me para elektronike;
 - 4.4. të zbatojë aktet juridike për ruajtjen e të dhënave dhe të sekretit; dhe

4.5. të njoftojë me shkrim tregtarin për propozimet e ndryshimeve të dispozitave të kontratës.

Neni 14

Standardet për mbrojtjen e mbajtësit të parasë elektronike

1. Pranuesi, në kontratën sipas nenit 13 të kësaj rregullore, sigurohet të përfshijë në përmbajtjen e saj masat e sigurisë dhe procedurat e nevojshme për mbrojtjen e mbajtësit, sipas të cilave tregtari:
 - 1.1. mund t'i kërkojë mbajtësit paraqitjen e një dokumenti identifikimi, në rast dyshimi për identitetin e tij, përpara pranimit të një pagese me para elektronike;
 - 1.2. duhet të refuzojë pranimin e një pagese me para elektronike, në rastet e mëposhtme:
 - 1.2.1. pavlefshmërisë së instrumentit të parasë elektronike;
 - 1.2.2. njoftimit për grabitje apo humbje të një instrumenti të parasë elektronike;
 - 1.2.3. mospërputhjes së nënshkrimit të autorizuar në instrumentin e parasë elektronike me nënshkrimin e dokumentit të transaksionit apo mjetit të identifikimit,
 - 1.2.4. refuzimit nga ana e mbajtësit për të treguar një dokument identifikimi ose nëse tregtari identifikon që një person i paautorizuar përdor instrumentin e parasë elektronike;
 - 1.2.5. pamundësisë së marrjes së konfirmimit për kryerjen e transaksionit;
 - 1.2.6. mungesës ose pasaktësisë në të paktën një elementi sigurie të instrumentit të parasë elektronike;
 - 1.2.7. dyshimeve për një falsifikim/kopjim të instrumentit të parasë elektronike.
 - 1.3. mund të mbajë instrumentin e parasë elektronike, në rastet e mëposhtme:
 - 1.3.1. lajmërimit për grabitje apo humbje;
 - 1.3.2. mospërputhjes së nënshkrimit në instrumentin e parasë elektronike me nënshkrimin në dokumentin e transaksionit apo dokumentin identifikues;
 - 1.3.3. përdorimit të instrumentit të parasë elektronike nga një person i paautorizuar;
 - 1.3.4. marrjes së një urdhri nga lëshuesi për mbajtjen e instrumentit të parasë elektronike; dhe
 - 1.3.5. konstatimit se të paktën njëri nga elementet e sigurisë nuk është i saktë.
 - 1.4. duhet të aplikojë procedurat e duhura të sigurisë dhe të mos bëjë publike të dhënat personale dhe të dhënat identifikuese të instrumentit, personave të paautorizuar si dhe të mos lejojë përdorim të gabuar/pasaktë, falsifikim/kopjim apo keqpërdorim të instrumentit të parasë elektronike;
 - 1.5. duhet të pranojë pagesat e kryera nëpërmjet parasë elektronike, brenda të njëjtëve terma dhe kushte si për pagesat në para të gatshme dhe nuk duhet të aplikojë ndaj mbajtësit komision apo tarifa shtesë, mbi çmimin e pagesave të kryera nëpërmjet tyre.

Neni 15

E drejta e mbajtësit për informim

1. Emetuesi informon mbajtësin mbi transaksionet e kryera me instrumentin e parasë elektronike si dhe mbi tepricën (vlerën outstanding) e fondeve të mbetura dhe të ruajtura në të.
2. Informacioni i përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni, vihet në dispozicion të mbajtësit me kërkesën e tij.

Neni 16
Humbja ose dëmtimi

Në rastet e verifikimit të humbjes ose dëmtimit të instrumentit të parasë elektronike, emetuesi i kthen mbajtësit fondet e mbetura, në përputhje me kushtet e përcaktuara në kontratën ndërmjet palëve, përveç nëse një instrument i ri është lëshuar dhe vënë në dispozicion të mbajtësit në një periudhë e arsyeshme kohore.

Neni 17
Raportimi në BQK

1. Emetuesi i parasë elektronike, raporton në BQK, sipas formatit të përcaktuar nga kjo e fundit.

Neni 18
Mbajtja e regjistrit të emetuesëve të parasë elektronike

BQK-ja publikon në ueb faqen e saj një regjistër me emetuesit e licencuar/regjistruar të parasë elektronike.

Neni 19
Masat përmirësuese dhe dënimet civile

Çdo shkelje e dispozitave të kësaj rregullore do të jetë subjekt i masave përmirësuese dhe ndëshkimeve administrative, siç përcaktohet në Ligjin për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, Ligjin për Bankat, Institucione Mikrofinanciare dhe Institucione Financiare Jobankare si dhe Ligjin për Sistemin e Pagesave.

Neni 20
Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi më 1 janar 2020.

Flamur Mrasori

Kryetari i Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës